

## **SYLLABUSI i Lëndës Financat për Biznes**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakultetit Ekonomik
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Financat për Biznes</b>
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti i dytë – Semestri i Parë
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 ligjerata +1 ushtrime
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof.Ass.Dr. Veton Zeqiraj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	veton.zeqiraj@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Financat në biznes është lëndë bazike në departamentin e Menaxhmentit. Financat në biznes janë mënyra e të menduarit për problemet ekonomike që përfshinë pasigurinë gjatë periudhave të ndryshme kohore.</p> <p>Kjo lëndë është e dizajnuar për studentët e nivelit bachelor në mënyrë që studentet të kuptojnë se si financieret mendojnë, si ata i zbërthejnë komponentët e një probleme financiare dhe si ata marrin vendime si investitor për korporata në tregun financiar.</p> <p>Në fund të semestrit, studentet do ta familjarizohen me terminologjinë financiare. Studentët do t'i kuptojnë aspektet bazë për teorinë e financave, do t'i zhvillojnë aftësitë në përlllogaritjen financiare, të vlerësojnë mendimet financiare, si dhe do të nxisin zgjidhjen e problemeve financiare. Studentët do të mësojnë si ta vlerësojnë rrezikun, marrin vendime financiare dhe si të vlerësojnë një investim si mundësi potenciale financiare dhe politiken e dividendit.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Nëpërmjet ligjëratave, analizave të rastit, seminareve, dhe zbatimit të formulave dhe funksioneve matematikore - financiare, studentët do të jenë të aftë:

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të kuptojnë konceptet bazë duke përfshirë qëllimet, dhe implikimet e financave në biznes si dhe rolin e vendimmarrësve financiar.</li> <li>2. Interpretimin e pasqyrave financiare dhe se si ato ndikojnë në planifikimin afatgjatë të rritjes së biznesit.</li> <li>3. Të kuptojnë rendësin e vlerës kohore të parasë për menaxher.</li> <li>4. Të kuptojnë se si firmat vendosin të tërheqin kapitalin e tyre dhe se si këto vendime ndikojnë në rrjedhën e parasë.</li> <li>5. Të kuptojnë normat e interesit si dhe rolin e tyre në investimet që bëjnë investitorë.</li> <li>6. Të kuptojnë kriteret e ndryshme që përdoren për të vlerësuar investimet e propozuara (p.sh normën e tanishme të interesit, profitabilitetin, normën e brendshme të kthimit).</li> <li>7. Të përcaktojnë koston e kapitalit si dhe të mësojnë se si të aplikojnë këtë koncept.</li> <li>8. Të njohin dhe të kuptojnë elementet bazë të strukturës së kapitalit dhe efektet e levës financiare, bankroptimit, dhe rolin e taksave në biznes.</li> <li>9. Të kuptojnë dinamiken e sjelljes financiare dhe ndikimin e saj në vendimmarrjen individuale dhe të korporatave financiare.</li> <li>10. Të kuptojnë llojet e derivateve në kontest të politikës për investim dhe financim që menaxheri i biznesit i bënë.</li> </ol>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Arritja e njohurive në nivelin e kërkuar lidhur me konceptet bazë të fushës së financave dhe aspekteve financiare, që do t'i përgjigjen kërkesave të tregut dhe të cilat kërkohen nga një student pas përfundimit të këtij kursi. Studentët do të demonstrojnë aftësi mbi politikën financiare,</p>

	<p>mjedisin dhe kushtet e financimit të një biznesi, vendimet që kanë të bëjnë me strukturën e kapitalit, vendimin për investime, vendimet që lidhen me financimin e biznesit, çështje e menaxhimit të kapitalit punues, dhe politiken e dividendit.</p> <p>Gjithashtu studentët pas këtij kursi do të jenë në gjendje të aplikojnë dhe t'i zbatojnë formulat dhe funksionet matematikore që lidhen me fushën e financave në biznes. Gjatë këtij kursi studentet do të jenë në gjendje të aplikojnë DerivaGem (softuer për të bërë vlerësimin e opsioneve nga prof Hull), ku nëpërmjet këtij aplikacioni studentët do të kuptojnë nga afër se si të vlerësohen vendimet për investime dhe financim duke u bazuar në rezultatet që ofron ky aplikacion.</p>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime teorike/laboratorike	10	1	10
Punë praktike	9	1	9
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	1	2
Ushtrime në teren	5	2	10
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	3	2	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	0	0	0
Projektet,prezentimet ,etj	10	1	10
<b>Totali</b>			<b>100</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Gjatë këtij moduli ligjëratat do të organizohen në formën e diskutimi interaktiv dhe shtjellimit të
-------------------------------------	---

	<p>aspekteve financiare që duhet t'i zotërojnë studentët gjatë këtij moduli. Në fillim të çdo ligjëratë do të bëhet një prezantim i shkurtër mbi konceptet bazë të financave në biznes dhe sfidat që ata pritet t'i kenë në të ardhmen.</p> <p>Pjesa tjetër - orët e ushtrimeve do të organizohet për t'i analizuar dhe diskutuar pjesën e ligjëratave dhe t'i ofrohet studentëve mbështetje për pjesën që kanë nevojë me shumë shpjegime për pasqyrat financiare të bizneseve në Kosovë dhe ato jashtë Kosovës si dhe rastet e firmave dhe korporatave të ndryshme në botë që kanë pasur histori të ndryshme të zhvillimit ( duke përfshi rastet që sot ne i njohim si histori e suksesit dhe dështimi). Studentët gjatë këtij moduli do të ngarkohen në vazhdimësi me raste studimi të cilat do të ju ndihmojnë atyre të njohin me mirë Financat në Biznes për menaxher. Gjithashtu gjatë këtij moduli do të organizohet 4 kuize që do të ndihmoj si mësimdhënësin po ashtu studentin t'i identifikojmë se cila pjesë e materialit kërkon vëmendje me shumë në mënyre që të bëhet ridizajnimi i orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve.</p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Vlerësimi i studentëve bëhet në përputhje me rezultatet e pritura të të mësuarit. Shkalla e arritshmërisë së këtyre rezultateve matet përgjatë gjithë semestrit që lënda trajtohet, përmes dy testeve gjatë semestrit dhe përmes prezantimeve dhe detyrave të shtëpisë.</p> <p>Zbërthimi i poentimit që studentët e përfitojnë nga kontributet e ndryshme përgjatë semestrit:</p> <p>Testi i parë: 40 %  Testi i dytë: 40 %  Detyrat e shtëpisë: 10 %  Prezantimi i punës seminarike: 10 %.</p> <p>Për studentët që nuk kanë arritur të ndërtojnë notë kaluese apo të pranueshme gjatë semestrit, organizohet provimi, i cili ka ngarkesë 100% në notë.</p>

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Veton Zeqiraj, Financat ne Biznes. Ligjerata të Autorizuara</li> <li>2. Menaxhmenti Financiar, Teori dhe Praktike Eugene F. Brigham, Michael C. Ehrhardt, THOMSON, South Western, 2019</li> <li>3.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Business Finance, Theory and Practice, Eddie McLaney, Pearson, 2017.</li> <li>2. Financial Management, Theory and Practice, Eugene F. Brigham, Michael C. Ehrhardt, THOMSON, South Western, 2019</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në financat për biznes
<i>Java e dytë:</i>	Pasqyrat Financiare , interpretimi dhe roli i taksave në biznes
<i>Java e tretë:</i>	Vlera kohore e parasë
<i>Java e katërt:</i>	Struktura e Vendimmarrjes Financiare
<i>Java e pestë:</i>	Metodat e vlerësimit të investimeve dhe praktikat për matjen e tyre
<i>Java e gjashtë:</i>	Testi i Parë
<i>Java e shtatë:</i>	Risku dhe norma e kthimit
<i>Java e tetë:</i>	Teoria e portfolios dhe analiza e investimeve –aplikacionit DerivaGem
<i>Java e nëntë:</i>	Burimet e financimit afatgjatë
<i>Java e dhjetë:</i>	Llojet e tregjeve financiare dhe roli i tyre
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i kostos së kapitalit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vendimi për dividend
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Roli i menaxhimit te kapitalit punues ne suksesin e biznesit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Struktura financiare e korporatave ndërkombëtare dhe roli i menaxherit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i Dytë

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p>Profesori do të zbatoj më përpikmëri të gjithë përmbajtjen e syllabusit me standarde më të larta etike dhe orët e konsultimeve të përcaktuara më student. Studentëve u grantohet se do të jenë të hapur për diskutime dhe e drejta e fjalës, shpreje e mendimit, opinionit ndryshe dhe e drejta për të shprehur paknaqesi është e garantuar. Po ashtu, nga studentët kërkohet që ta respektojnë orarin, mbajtjen e diciplinës dhe respektimi i kodit të mirësjelles si gjatë mësimi po ashtu edhe gjatë testeve dhe provimeve.</p>